



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

KONKURS (i Brendshëm)

Titulli i pozitës: Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit

Ref: RN00002994

Njësia Organizative: Drejtoria e Kontrollit- AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Koeficienti: 10

Qëllimi i vendit të punës:

Drejtori i Drejtorisë është përgjegjës për organizimin, menaxhimin dhe kordinimin e punës për kontrollin në vend ngjarje/teren për të gjitha masat e zhvillimit rural dhe për pagesa direkte duke respektuar legjislacionin relevant dhe procedurat e shkruara për kontroll. Është përgjegjës për ndarjen e funksioneve dhe detyrave brenda drejtorisë.

Detyrat kryesore:

- 1.Udhëheqë dhe cakton objektivat e drejtorise në përputhje me strategjine dhe objektivat e AZHB-se dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për ti përmbushur këto objektiva; 20%
- 2.Menaxhon stafin dhe buxhetin e drejtorisë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit;15 %
- 3.Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme duke mbikqyr dhe mbështet hartimin dhe rishikimin e rregulloreve, instruksioneve, manualeve të procedurave, raportet e kontrollit, listave të kontrollit për implementimin e kontrollit ne vend ngjarje të programit të zhvillimit rural dhe PD duke rekomanduar ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë; 15%
- 4.Mbikëqyr dhe mbështet hartimin dhe rishikimin e rregulloreve,instruksioneve, raportet e kontrollit, listave të kontrollit në vendngjarje për të gjitha masat e zhvillimit rural dhe Pagesave Direkte;15
5. Bën përgatitjen e planeve vjetore të kontrollit dhe urdhrat e kontrollit, analizimin dhe miratimin e planeve dhe raporteve të punës të sektorëve përkatës; 10%
- 6.Organizon dhe kryen kontrollet në terren , në mbikëqyrje dhe verifikim të punës së Inspektoriatit të Terrenit; 10%
7. Përgatit raporte mbi të gjeturat e kontrolleve të kryera në terren; 10%
- 8.Bën vlerësimin e stafit dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve, seminareve, takimeve 5%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

Njohuri paraprake në fushën e kontrollit;

Diploma Universitare: **Shkenca të Ekonomisë, Bujqësi ose Relevante;**

Përvoja në punë: 6 vite përvojë pune profesionale - 3 vite përvojë në vende udhëheqëse; Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)

Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;

Shkathtësi në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;

Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

Data e shpalljes së konkursit me: 06.04.2018

Data e mbylljes së konkursit me: 13.04.2018

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 16 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.